

20241943345

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NGA
BANKA HUNGAREZE EKSPORT-IMPORT, SHOQËRI PRIVATE ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN BUXHETOR
DHE FINANCIMIN E QËLLIMEVE TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Hungareze e Eksport-Importit, shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me kredi në vlerë prej 500.000.000 eurosh, e dedikuar për financim buxhetor dhe financim për qëllime të përgjithshme.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua, që do të nënshkruhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Hungareze e Eksport-Importit, shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 3

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të tërhiqet në një transhë.

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tre vjetësh.

Norma e interesit është fikse dhe është 3.25%.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Hungareze të Eksport-Importit, kompani private me përgjegjësi të kufizuar, për mjetet e patërhequra në shumën prej 0,5% të kredisë në vit.

Provizioni për mjetet e pa tërhequra do të llogaritet në baza ditore mbi pjesën e pa tërhequr të huas, e llogaritur nga data e disponueshmërisë së mjeteve dhe do të paguhet në ditën e parë të punës pas përfundimit të periudhës së disponueshmërisë.

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të paguhet më me 24 këste gjashtëmujore, në datat 15 shkurt dhe 15 gusht çdo vit.

Neni 4

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen për hua nga neni 2 të këtij ligji do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut kredinë nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.